



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1112/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Nemanja Jakšić kandidat për asamble kuvendit komunale nga subjekti politik G.I. Srpska dega në Zubin Potok, paraqitur kundër komisionerëve të qendrave të vendvotimeve për shkak të parregullsive dhe manipulimit të votave gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Nemanja Jakšić kandidat për kuvendin komunal në Zubin Potok nga radhët e subjekti politik G.I. Srpska.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Nemanja Jakšić anëtar për asamble komunale nga subjekti politik G.I. Srpska dega në Zubin Potok, i cili pretendon se i janë dëmtuar disa ulëse të anëtarëve, edhe pse mendon se në bazë të votave të numëruara ju takojnë më shumë se 11 anëtarë i caktuar me vendimin e KQZ-së. Në këtë rast mendoj se nuk i kanë përfshirë mirë votat e numëruara, duke emarr parasysh se G.I. Srpska ka fituar me shume vota se partitë tjera më pak dhe ato parti kanë fituar më shumë vota. Partia e LDK-së i ka fituar 25 vota më pak se që është publikuar nga KQZ-ja, PDK-ja i ka fituar 45 vota më pak se që është publikuar, dhe SD-ja i ka fituar 25 vota më pak. Parashtruesi i ankesës pretendon se është dëmtuar më shumë se 400 vota dhe kështu është i dëmtuar për disa ulëse në asamble komunale.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se në shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesit Nemanja Jakšić nga komuna e Zubin Potokut se subjektit politik G.I. Srpska i janë vjedhur dhe i është bërë manipulim me vota e këtij subjekti. PZAP-i, vlerësoi si të pa bazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse siç pretendon pala ankuese andaj ankesa e tillë është e pa bazuar dhe në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe

neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartpërmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr. 1112/2013 më datën 06.12.2013



**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**

Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 (njëzetkatër) orë nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.